



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 193/9 Akti

Tiranë, më 22.05.2020

**V E N D I M**

Nr.33, Datë 22.05.2020

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 20, datë 13.02.2020 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në këtë institucion.

Instituti i Integritetit të Përndjekurve Politikë është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, veprimtaria e të cilit përcaktohet dhe rregullohet me ligjin nr. 8246, datë 01.10.1997 *“Për Institutin e Integritetit të Përndjekurve”*, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 193/1, datë 13.02.2020, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 193/2, datë 13.02.2020 *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Institutin e Integritit të Përndjekurve Politikë”*, i është njoftuar subjektit të mbikëqyrjes.

Pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën nr. 198 prot., datë 13.05.2020 *“Projektraporti i mbikëqyrjes në Institutin e Integritit të Përndjekurve Politikë në lidhje me administrimin e shërbimit civil” (protokolluar në KMSHC me nr. 193/8 prot., datë 15.05.2020)*, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015,

## V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Të materializohet në strukturë parimi i hierarkisë administrative në shërbimin civil, duke propozuar në strukturën pasardhëse, krijimin e njësisë organizative me emërtesën *“Drejtori”*, me qëllim që të sigurohet linja e raportimit nga nivelet e ulta, në nivelin më të lartë (*Sektor-Drejtori-Drejtor i Përgjithshëm*), parashikuar në nenet 12 – 14, Kreu III *“Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore”*, Seksioni 2 *“Institucionet e varësisë”*, të ligjit nr.90/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*.
3. Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur si dhe njësia përgjegjëse DAP, të materializojnë në formë shkresore, procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil dhe janë kryer vetëm në mënyrë elektronike, duke respektuar elementët që duhet të përmbajë kopja në letër e dokumentit elektronik, të përcaktuara në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008 *“Për nënshkrimin elektronik”*, i ndryshuar; ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 *“Për dokumentin elektronik”*.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30 ditë** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
5. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi si dhe të dërgojë dokumentacionin që vërteton masat e marra për të rregulluar situatën e ligjshmërisë.
6. Për këtë vendim të njoftohet Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**